


LUMI - PROTOKOLLI OSPAR

5 Hapa Kryesorë

për një zbatim të suksesshëm



HYRJE

Mbeturinat e gjetura në oqeanë transportohen kryesisht atje nëpërmjet rrugëve ujore; megjithatë, ato nuk mbërrijën atje menjëherë. Të lëkundura në rrymë dhe të shtyra nga era, një pjesë e tyre përfundon në brigjet e lumenjve, ku mund të qëndrojnë dhe të grumbullohet për periudha të gjata.

Mbledhja e të dhënave lidhur me këto mbetje na ndihmon të kuptojmë më mirë ndotjen e lumenjve:

- **Duke përmirësuar njohuritë** për llojin e mbetjeve, sasimë totale dhe mënyrën e shpërndarjes;
- **Duke ndihmuar në përcaktimin e objektivave të qarta** (për shembull, objektivi aktual është të kemi më pak se 20 copë mbeturina për 100 metra vijë bregdetare);
- **Duke orientuar zbatimin e zgjidhjeve lokale** ndërkohë që forcohet zëri ynë në nivel evropian;
- **Duke vlerësuar efektivitetin** e masave ekzistuese.

Për të gjitha këto arsye, Fondacioni Surfrider, i cili ka drejtuar rrjetin e monitorimit të mbetjeve detare, OSPAR, përgjatë vijës bregdetare që nga viti 2010, tani po punon për të zgjeruar këtë rrjet edhe në lumenj. Grupet në nivel vendor të Surfrider-it mund të ndihmojnë në zgjerimin e njohurive tona në shkallë evropiane.


“Vullnetarët e shkencës” qëndrojnë në thelb të qasjes sonë dhe ky udhëzues është hartuar për të mbështetur në mënyrën më të mirë të mundshme zbatimin e këtij protokollit, së bashku me udhëzimet e personalizuara nga ekipi ynë.

Faleminderit për angazhimin dhe energjinë tuaj, përfshirja juaj i gjallëron dhe u jep jetë projekteve të Fondacionit Surfrider brenda këtij komuniteti të jashtëzakonshëm vullnetarësh.

Së bashku, mund të ndërtojmë një rrjet monitorimi ambicioz dhe ndikues!



Lexim të këndshëm!



1

KONTEKSTI

Korniza Evropiane

Mbetjet

Monitorimi

OSPAR

2

KËRKIMI PËR NJË ZONË IDEALE

Vendndodhja

Mbërritshmëria

Siguria

3

PARA SE TË FILLONI

Lista se ç'duhet bërë

Autorizimet

Pikat e referencës

4

ORGANIZIMI I GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE

Planifikimi

4 herë/vit

Grumbullimi i mbeturinave

5

NDARJA E MBETJEVE TË GRUMBULLUARA

Kategorizimi

Materialet


Peshimi

6

SHEMBULL: ZONA E SURFRIDER-IT NË LUMIN NIVE


Dëshmi

Foto



1 KONTEKSTI

HARTA E KONTEKSTIT EVROPIAN



Studimi i përhapjes së mbetjeve të ngurta në lumenj është një fushë relativisht e re dhe janë ende të kufizuara të dhënat e disponueshme.

Aktualisht, kuadri kryesor legjislativ që trajton ndotjen ujore vjen nga një direktivë evropiane e hartuar për mjedisin detar: Direktiva Kornizë e Strategjisë Detare (MSFD)*.

Krahas kësaj direktive, dy konventa rajonale detare luajnë një rol kyç në koordinimin e veprimeve:

- Konventa OSPAR, e cila përqendrohet në mbrojtjen e Atlantikut Verilindor, dhe
- Konventa e Barcelonës, për ruajtjen e Detit Mesdhe.


Këto konventa mbështesin masa të koordinuara midis vendeve, duke përfshirë zbatimin e një protokolli të standardizuar të monitorimit të mbetjeve të njohur si Protokolli OSPAR. Metodologjia e tij bazohet në grumbullimin sistematik dhe karakterizimin e detajuar të mbetjeve të gjetura në vende specifike gjatë një periudhe afatgjatë.

*E miratuar në vitin 2008, kjo ishte politika e parë që njohu zyrtarisht se mbetjet ndikojnë drejtpërdrejt në gjendjen mjedisore të trupave ujore. Ajo përcakton objektiva të përbashkëta për vendet e BE-së për të mbrojtur oqeanin.

Qëllimi kryesor i kësaj pjese të Konventës OSPAR është reduktimi i sasisë së mbeturinave që hyjnë në oqean në nivele që nuk e vënë në rrezik mjedisin. Në vitin 2022, u miratua Plani i Dytë Rajonal i Veprimit për Mbetjet Detare (RAP ML 2). Një nga objektivat e tij kryesorë për vitin 2030, i formalizuar në Veprimin A.3.1., është zgjerimi i përpjekjeve të monitorimit për të përfshirë **makro-mbetjet** (grimcat më të mëdha se 5 mm) në **rrjetet hidrografike** (lumenjtë!).

Disa vende evropiane, përfshirë Holandën, Belgjikën dhe Francën, kanë eksperimentuar tashmë me monitorimin e mbetjeve lumore. Protokolli OSPAR mund të shërbejë si një referencë e vlefshme ndërkombëtare në standardizimin e këtyre përpjekjeve.

Në Francë, u krijua Rrjeti Kombëtar i Monitorimit të Makro-Mbetjeve të Lumenjve për të plotësuar programet ekzistuese të monitorimit të bregdetit. Kjo iniciativë pilotohet nga CEDRE (Centre de Documentation, de Recherche et d'Expérimentation sur les Pollutions Accidentelles de l'Eau / Qendra për Dokumentim, Kërkim dhe Eksperimentim mbi Ndotjen Aksidentale të Ujit), megjithatë, ajo merr parasysh vetëm seksionet e lumenjve pranë grykëderdhjeve.



Ne besojmë se është i rëndësishëm zgjerimi i zonave të monitorimit OSPAR përgjatë gjithë gjatësisë së lumenjve në Evropë. Kjo do të na lejonte të mbledhim të dhëna kritike tani dhe të demonstrojmë rëndësinë e monitorimit të mbetjeve edhe në rrjedhën e sipërme të grykëderdhjeve.

2

KËRKIMI PËR NJË ZONË IDEALE

ÇFARË TË KEMI PARASYSH QË NË FILLIM

1

Siguria është e para! Mos kërkoni në zona të rrezikshme, shmangni zonat me rrjedhë të lartë, përrrenjtë dhe mjedise të ngjashme.

2

Kërkoni përgjatë një ose më shumë rrugëve ujore brenda një distance të arsyeshme nga vendi juaj i zakonshëm i takimit. Udhëtimi me makinë deri në zonë nuk duhet të zërë pjesën më të gjatë të një dite të Protokollit OSPAR.

KARAKTERISTIKAT E DËSHIRUESHME QË DUHEN KËRKUAR NË NJË ZONË

BËNI

Sipërfaqja

- ✓ Gjatësia: Minimumi 50 m, idealisht 100 m.
- ✓ Gjerësia:
 - Kufiri i poshtëm: vija e ujit ose substrati i paqëndrueshëm (baltë)
 - Kufiri i sipërm: argjinaturë, shkëmbinj të thyer, shenja e nivelit më të lartë të ujit* ose shteg për kalimtarë
- ✓ I arritshëm gjatë gjithë vitit, duke marrë parasysh luhatjet sezonale të nivelit të ujit.

Mbërritje e sigurt

- ✓ Makinë arrin lehtë për grumbullimin e mbeturinave.
- ✓ Nuk ka rrezik të shkohet më këmbë: kujdes rrotull shkëmbinjve, sipërfaqeve me baltë dhe argjinaturave të pjerrëta.

Prania e mbeturinave


- ✓ Ka mbeturina që janë grumbulluar gjatë një periudhe pak a shumë të gjatë.
- ✓ Zonë poshtë rrjedhës së lumit nga një zonë me aktivitet ekonomik (bujqësi, zona urbane, zona industriale...).

MOS BËNI

- ✗ Bimësi e tepërt në pranverë/verë, që mund të pengojë protokollin e grumbullimit.
- ✗ Operacione të njohura pastrimi ndërkohë që merren mostra.

* ÇFARË ËSHTË SHENJA E NIVELIT MË TË LARTË TË UJIT?

Ashtu siç shenja që sinjalizon baticën mund të jetë e dukshme në plazhe, shenja e nivelit të lartë të ujit është gjurma që mbetet në brigjet e lumit kur nivelet e ujit bien. Shpesh do të gjeni shumë materiale organike atje - dhe ndonjëherë edhe mbeturina!



SI TË PIKETONI ZONËN?



1. **Vëzhgoni zona të përshtatshme me anë të imazheve ajrore** (me Google Maps, Google Earth, etj.) dhe kërkoni:
 - ☐ **Brigje lumi ku është e mundur të mbërrihet**
 - ☐ **Seksione gjarpëruese të lumit**, ku mbeturinat kanë tendencë të grumbullohen.



Kini kujdes se imazhet ajrore mund t'ju gënjejnë: nëse nuk duket asnjë breg lumi, ai mund të jetë thjesht i fshehur nën kurorat e pemëve ose i mbuluar nga baticat në vendet që ndikohen nga baticat.



KËSHILLË

Përdorni **Streetview** në **Google Maps** nëse është i disponueshëm në zonë. Mund të zbulojë brigje të qarta lumenjsh që nuk janë të dukshme prej imazheve satelitore.



2. Vizitoni zonën për të konfirmuar vëzhgimet tuaja dhe për të vlerësuar mbërritshmërinë, sigurinë dhe praninë e mbeturinave. Në varësi të kushteve, mund ta eksploroni zonën me:

- ☐ **Biçikletë** përgjatë një shtegu për kalimtarë: është e lehtë të shihet bregu përballë.
- ☐ **Kanoe** me udhërrëfyes: është e lehtë të shihen të dy brigjet e lumit.
- ☐ Me **makinë** dhe në **këmbë**.



A ËSHTË KJO NJË ZONË E MIRË PËR STUDIM?




Na pyetni:

dërgoni fotografi dhe një përshkrim të zonës dhe ne mund të diskutojmë dhe zgjedhim së bashku zonat.

Është më mirë të bëhet vëzhgim përgjatë një viti

për të ndjekur ndryshimet sezonale të zonës (ndryshimet e nivelit të ujit, ndryshimet në brigjet e lumit, mbërritshmëria dhe rritja e bimëve në pranverë dhe verë). Kjo do ta bëjë më të qartë nëse zona është e përshtatshme për përzgjedhje për monitorim afatgjatë, apo nëse mund të jenë më të favorshme zona të tjera.



3

PARA SE TË FILLONI

KARAKTERIZIMI I ZONËS



Përcaktoni pika orientimi ose referimi të përherëshme (pemë specifike, një tabelë orientuese) si kufij në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme. Regjistroni koordinatat e tyre GPS.



KËSHILLË

Në **Google Maps**, mund të shënoni një vend në hartë dhe ta ruani atë në një listë. Është një mënyrë e mirë për të ndjekur koordinatat GPS dhe për të vizualizuar shenjat tuaja në hartë.



KËSHILLË

Mbetjet duhet të mbliidhen gjithmonë nga e njëjta shtrirje midis dy kufijve të paracaktuar. Kjo lejon ndjekjen e një protokollit të standardizuar.

Megjithatë, **gjerësia e shtrirjes mund të ndryshojë në varësi të kushteve.**

Një njësi e rëndësishme që mundëson krahasimin midis zonave është “numri i mbeturinave për 100 metra”. Prandaj, konsistenca në gjatësi është kriteri më i rëndësishëm për t'u patur parasysh.



Plotësoni formularin e përshkrimit të zonës: shënoni pjerrësinë, llojin e substratit (rërë, baltë, shkëmbinj, zhavorr...) dhe aktivitetin kryesor ekonomik në zonën përreth.




Përcaktoni nivelin e ujit që do të përmblytë zonën.



KËSHILLË

Në Francë, faqja e internetit **vigicrues.gouv.fr** ofron të dhëna në kohë reale për nivelin e ujit në zona specifike. Mund t'i krahasoni këto të dhëna me vëzhgimet tuaja në terren. Kontrolloni nëse mjete të ngjashme janë të disponueshme në vendin tuaj.



Nëse zona ndikohet nga luhatjet e baticës, vini re ndryshimin kohor midis zbaticës në portin më të afërt dhe zbaticës në zonën tuaj të monitorimit.



Bëni fotografi.

PËRGATITJA E PROJEKTIT




Nëse për të mbërritur në bregun e lumit duhet kaluar nëpër një pronë private ku nuk ka shtigje publike, merrni leje me shkrim nga pronari i tokës.



Informoni autoritetet vendore (p.sh., bashkinë) me email në lidhje me zbatimin e protokollit të monitorimit.




Ne mund të ofrojmë **modele email-i** sipas kërkesës për të kontaktuar pronarët e tokave ose autoritetet vendore ku të prezantoni projektin.



Planifikoni katër misione në vit, nga një për çdo stinë: janar-mars, prill-qershor, korrik-shtator dhe tetor-dhjetor.



Planifikoni grumbullimin **në fillim të stinës** për të manovruar në rast se do t'ju duhet të riplanifikoni për shkak të kushteve të motit ose të lumit.



Kryeni seancën e parë të pastrimit dhe ndarjes së mbeturinave me stafin ose vullnetarët me përvojë të Surfrider-it, në mënyrë që të bëheni operatorë të këtij protokollit.



Ndryshe nga programi i Iniciativës për Oqeanet, këto janë përpjekje thjesht **shkencore** dhe nuk duhet të përfshijnë publikun për të rritur ndërgjegjësimin. Për të siguruar **konsistencën e të dhënave**, vetëm ekipi që është trajnuar duhet ta zbatojë protokollin.

PLANIFIKIMI I DITËS SË PROTOKOLLIT



Organizoni misionin disa javë më parë në mënyrë që ekipi të jetë gati. Caktoni gjysmë dite për secilin hap (grumbullimi i mbeturinave dhe më pas ndarja e tyre dhe regjistrimi i të dhënave).



Lidhur me grumbullimin e mbeturinave, nëse vendi ka baticë-zbaticë, lëvizni vërdallë zbaticës për të grumbulluar mbeturinat e lëna nga uji që po tërhiqet.



Bëni kujdes me kushtet e motit dhe të ujit një javë para aktivitetit: a do të jetë zona mbi nivelin e ujit? A do ta lejojnë këtë kushtet në terren?



4 ORGANIZIMI I GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE

Pritni nga 30 minuta deri në 1.5 orë për grumbullimin e mbeturinave me një ekip prej 2 deri në 6 personash.



1. **Si ekip, përcaktoni zonën e studimit sipas kushteve të ditës** (niveli i ujit, ekspozimi i brigjeve të lumit).
2. **Ekipi duhet të fillojë nga njëri skaj i zonës, të formojë një vijë dhe të ecë paralelisht me rrjedhën e lumit.** Të bëjë të paktën një xhiro në secilin drejtim: çdo pjesë e segmentit duhet të vëzhgohet nga të dy këndet.

BËNI

Grumbulloni

- ✓ Mbeturina më të mëdha se 5 mm. Mund të grumbullohen edhe sendet më të vogla, por nuk duhen numëruar.
- ✓ Mbeturit në breg të lumit dhe të ngecura mes bimëve.

MOS BËNI

Lëreni

- ✗ Mbeturit e groposura ose që kanë mbetur nën ujë.
- ✗ Mbetjet organike: mbetje bimë ose mbetje shtazore, siç janë kockat.

TRAJTIMI I MBETJEVE MASIVE

Objektet masive përfshijnë mbeturina që janë shumë të mëdha ose të rënda për t'u zhvendosur: trarë, goma ose bateri makinash, biçikleta, pajisje elektroshtëpiake...

Çfarë informacioni duhet të regjistroni?

- Bëni **fotografi**.
- Vlerësoni **vëllimin** e sendit dhe, nëse është e mundur, **peshojeni** në vend.
- **Regjistroni detajet** në formularin e grumbullimit.

What should you do with bulky objects?

- If Nëse është e mundur, **hiqini ato nga zona dhe çojini në qendrat e asgjësimit**.
- Nëse jo, zhvendosini sa më larg ujit të jetë e mundur për të **shmangur transportimin më tej në rrjedhën e poshtme**. Më e mira do të ishte t'i vendosni në një vend nga ku mund të merren dhe të asgjësohen prej shërbimit të pastrimit.
- Nëse nuk ekzistojnë **mundësi të sigurt heqjeje**, lërin aty ku janë.



5

NDARJA E MBETJEVE TË GRUMBULLUARA

**Pritet që ky hap të zgjasë nga 1 deri në 3 orë
me një ekip prej 2 deri në 6 personash.**

PAJISJET E NDARJES SË MBETJEVE



Nëse mund të shfrytëzoni një hapësirë të mbuluar të jashtme ose garazh, transportimi i mbeturinave drejt këtij vendin për procesin e ndarjes mund të jetë më i përshtatshëm.

Ose, procesi i ndarjes mund të zhvillohet direkt në zonë.



Mbuloni një tavolin me mushama mbrojtëse që të mos përkulni trupin dhe të mos lodheni gjatë këtij procesi.



SISTEMI *ZYRTAR* I KLASIFIKIMIT SIPAS OSPAR

251

**Kategori,
Vetëm kaq?!**

Lista mund të duket shumë specifike, por ndihmon në standardizimin e mbledhjes së të dhënave në të gjithë Evropën. Kur të organizoni misionin tuaj të parë, stafi i Surfrider-it do të marrë pjesë dhe do t'ju ofrojë udhëzime të dobishme se si të përdorni sistemin në një mënyrë të organizuar dhe efektive. Me kalimin e kohës, ndërsa njiheni më shumë me metodën, ndarja e mbetjeve do të bëhet e natyrshme.

Klasifikimi përbëhet nga:

- ➔ **7 kategori të gjera** sipas materialit parësor nga i cili përbëhen mbetjet: polimere plastike, metal, dru i përpunuar, letër dhe karton, qelq dhe qeramikë, tekstile dhe produkte kimike.
- ➔ **Nënkategoritë** bazuar në përdorimin e synuar të artikullit (ambalazh ushqimor, produkte higjienike, aktivitete argëtuese, materiale ndërtimi...).
- ➔ **Fragmente të paidentifikuara**, të kategorizuara sipas materialit dhe madhësisë kur përdorimi origjinal nuk është më i dallueshëm.

PLOTËSIMI I FORMULARIT TË GRUMBULLIMIT



Kategorizoni çdo artikull.



Nëse nuk jeni të sigurt si të klasifikoni një artikull, në seksionin “komente”, shkruani një përshkrim të **kategorisë më të përshtatshme**.




Mos hezitoni të na kontaktoni ose të na dërgoni fotografi të artikujve dhe ne mund t'ju ndihmojmë t'i identifikoni ato.



Nëse artikujt nuk hyjnë në asnjërën prej kategorive: përshkruajini ato në fund të formularit në seksionin e komenteve. Nëse artikuj të pakategorizuar gjenden rregullisht, lista mund të përshtatet në përputhje me rrethanat.



Në seksionin “**Përmbledhje**” për secilin lloj mbeturine, shënoni **masën** dhe **vëllimin** e materialit. Siç tregohet, peshoni plastikat veçmas.



Shënoni çdo **faktor mjedisor** (shira të rrëmbyeshëm, erëra, përmbajtje të kohëve të fundit) dhe **njerëzor** (ndërtim, festime të kohëve të fundit në zonë) që mund të ndikojnë në praninë e mbetjeve në ditën e misionit, si dhe çdo informacion që mund të jetë i rëndësishëm.




Dërgojini formularët në adresën e Sabine Allou (sallou@surfrider.eu). The data will be reviewed and securely stored.

Kaq ishte! Procesi përfundoi!




6

SHEMBULL: ZONA E SURFRIDER NË LUMIN NIVE



INFORMACIONE TË RËNDËSISHME

- Zona u zgjodh në **vjeshtën e vitit 2024**.
- **Vendndodhja:** Menjëherë poshtë rrjedhës së lumit nga një digë, në komunën e **Ustaritzit**.
- **Ndikimi i baticës:** Zona ndikohet nga baticat, sipas kriterëve të Rrjetit Kombëtar të Monitorimit CEDRE.
- **Gjatësia:** 100 metra.
- **Gjerësia:** Varion midis 15 dhe 45 metrave, varësisht nga vendndodhja, duke ndryshuar në varësi të kushteve të baticës dhe niveleve të ujit.
- **Pjerrësia:** E ulët.
- **Llojet e substratit:** Një përzierje guralecash, rëre dhe llumi.
- **Shtresat e bimësisë:** Përfshijnë shtresat e bimësisë barishtore, shkurreve dhe drurëve.



REZULTATET E GRUMBULLIMIT TË PARË

- **Data:** 14 nëntor 2024
- **Ekipi me 4 persona**
- **Ora e fillimit:** 1 orë pas zbatimit në det (niveli më i ulët i ujit në zonë)
- **Niveli i ujit:** 1.82 metra
- **Kohëzgjatja e grumbullimit:** 1 orë
- **Kohëzgjatja e ndarjes së mbetjeve:** 1.5 orë
- **Mbetjet e grumbulluara:**

- 76.9 kg, duke përfshirë 41.7 kg mbetje masive dhe 20 kg mbetje plastike.
- Kjo përfaqëson një vëllim total prej 200 litrash mbetje, duke përfshirë 100 litra sende masive dhe 80 litra mbetje plastike.
- Artikujt më të zakonshëm masivë: kompesata druri dhe 3 goma.
- Sasi të mëdha rrënojash dhe fragmentesh qeramike në plazhin me guralecë—tani të integruara në sediment dhe të pa hequra.
- U gjet një numër i madh këpucësh dhe shuajsh të vjetër. Ne hetuam origjinën e tyre duke diskutuar me vendasit dhe mësuam se më parë fabrikat e këpucëve ndodheshin në luginë.

Përfundimi ynë kryesor?

Çdo zonë është e veçantë, për sa kohë që ka një segment të pastër prej 100 m (ose 50 m), një grumbull mbeturinash dhe një pikë hyrjeje të sigurt gjatë gjithë vitit – bëjeni tuajin!

Është radha jote!

AUTORËT

Clémence Gibault

Sabine Allou

Dizenjuar nga Astrid Manoukian

ME MBËSHTETJEN E

Ky projekt ka marrë financim nga programi LIFE i Bashkimit Evropian. Mbështetja e Komisionit Evropian për prodhimin e kësaj publikimi nuk përbën miratim të përmbajtjes së tij, e cila pasqyron vetëm qëndrimet e autorëve, dhe Komisioni nuk mund të mbahet përgjegjës për çdo përdorim që mund t'i bëhet informacionit të përfshirë në të.



Qershor 2025